

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	A mund ta shkatërrojë njerëzimin inteligjenca artificiale?
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/19/a-mund-ta-shkaterroje-njerezimin-inteligjenca-artificial-e/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 14:42:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 14:42:24 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b485319439efa706d24cb89e01446604ec27a0396f6a1be92d7304f68c4ed321
TEKSTI	0af234665f484678620bf5fecbedb9c8cd660f1745f3b903f04982d8c290d432
PAMJA	707f579254bfa38de613d3c1bf0541d5cdba03e77c35db59306a9046da2d707e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a26b7364dcf945515c5676ab2a3138220e29b56cf23b2734b7753b0fd911ea04
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	46a7af3000d16e9ffefcbfa0ca0d8af83c85fda72b67353c14db1e839b49f770
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a26b7364dcf945515c5676ab2a3138220e29b56cf23b2734b7753b0fd911ea04

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > BOTA

A mund ta shkatërrojë njerëzimin inteligjenca artificiale?

16:42 : 19/09/2026 në BOTA, NDRYSHE, Teknologji



Inteligjenca artificiale po zhvillohet me ritëm të shpejtë, duke nxitur njëkohësisht diskutime për rreziqet që mund të sjellë.

Një nga pyetjet që po shtrihet gjithnjë e më shumë është nëse, një ditë, njerëzimi mund ta humbë kontrollin mbi këtë teknologji.

Darsej Riza, bashkëthemelues dhe ekspert i teknologjisë në Shkollën Digjitale, në Prishtinë, thotë se niveli i rrezikshmërisë nga evoluimi që po bën inteligjenca artificiale është më i lartë se vetë bomba atomike që ka zbuluar njeriu.

“Jemi duke eksperimentuar me diçka që ende s’jemi duke e kuptuar si duhet”, shprehet Riza në podcastin 5 pyetje të Radios Evropa e Lirë.

Sipas tij, rreziku lidhet edhe me mundësinë që inteligjenca artificiale të arrijë një nivel ku mund të zhvillohet në mënyrë gjithnjë e më autonome.

Lexo edhe:

Korreshi ironizon Qeverinë: Fshati akoma te parmenda, ju na tregoni inteligjencën artificiale

Fituesja e Çmimit Nobel: Duhet ta kufizojmë inteligjencën artificiale, përndryshe njerëzit do humbasin kontrollin

“Kur të vendoset në një robot, për shembull, atëherë kemi krijuar një entitet të ri, a një specie të re brenda planetit tonë”, thotë ai.

A mund t'i vrasë inteligjenca artificiale njerëzit?

Riza tregon në 5 pyetje se një skenar i tillë nuk do të nënkuptonte domosdoshmërisht se inteligjenca artificiale do të synonte zhdukjen e njerëzimit për të njëjtat arsye që mund t'i ketë njeriu për të vrarë ose për t'i bërë dëm dikujt.

“Mund të jetë vetë faktori njeri që ia jep një instruksion, dhe që inteligjenca artificiale e keqkupton atë, dhe kryen veprim që nuk është paramenduar prej njeriut”, shprehet ai.

TË GJITHA



A mund ta shkatërrojë njerëzimin inteligjenca artificiale?

16:42 : 19/09/2026



“E godita në zemër.../ Vrau me thikë gruan, zbardhet dëshmia e Hysni Patushit

16:26 : 19/09/2026



Audiopërgjimi i Ron Yeffet/ Këlliçi: Rama, 12 ditë heshtje për koordinatorin e punëve të pista

16:13 : 19/09/2026



Harta e re territoriale/ Rama shkrin 15 bashki më 8 Tetor

15:56 : 19/09/2026



Shkrumbohet nga zjarri banesa në Bulqizë, bllokohet brenda banori me aftësi të kufizuara

15:39 : 19/09/2026



Trump thotë se SHBA-ja dhe Danimarka kanë arritur marrëveshje për Grenlandën

15:27 : 19/09/2026



Konfirmohen 7 raste me virusin e Nilit Perëndimor në Kosovë, 2 viktime

15:16 : 19/09/2026

Sipas Rizajt, rreziqet nga inteligjenca artificiale të janë të shumëfishta. Disa mund të parashikohen nga njeriu, disa jo, thotë ai.

“Po supozojmë, përmes inteligjencës artificiale, ne po arrijmë ta kontrollojmë motin. E krijojmë teknologjinë, e kontrollojmë motin, edhe kemi inteligjencë artificiale që na mirëmban atë mot për neve, që ta kemi motin ideal për planetin tonë”, e tregon si shembull ai.

Rreziku nga keqpërdorimi

Përveç skenarëve afatgjatë, Rizaj thotë se disa rreziqe tashmë janë të pranishme, veçanërisht sa i përket të dhënave personale dhe përmbytjeve të krijuara me modelat e inteligjencës artificiale.

Sipas tij, fotografitë, videot dhe të dhënat që njerëzit kanë publikuar ndër vite në internet mund të përdoren për trajnimin e sistemeve të inteligjencës artificiale.

Ai paralajmëron se zhvillimi i teknologjisë mund ta bëjë gjithnjë e më të vështirë dallimin mes përmbytjeve reale dhe atyre të krijuara artificialisht.

“Jemi duke arritur te pika ku nuk do të mundemi aq lehtë ta vërejmë a është reale, apo është krijuar me inteligjencë artificiale”, thotë Rizaj në 5 pyetje.

Sipas Rizajt, kjo mund të përdoret edhe për shantazh, dëmtim të reputacionit apo krijimin e materialeve të rreme.

“Kosova është mbrapa”

Sa i përket Kosovës, Rizaj thotë se inteligjenca artificiale ende nuk është pjesë e mjaftueshme e diskutimit institucional.

“Si Kosovë, mbrapa jemi”, thotë ai, duke shtuar se vendet e tjera të Ballkanit kanë nisur investime në qendra të të dhënave dhe kanë më shumë iniciativa strategjike.

Sipas tij, Kosova duhet të mendojë edhe për ndikimin që inteligjenca artificiale mund të ketë në tregun e punës.

Për Rizajn, edukimi për inteligjencën artificiale është një nga mënyrat kryesore për t’u përgatitur për ndryshimet që sjell kjo teknologji.

“Që të mund ta kuptojmë si të mbrohem, duhet të dimë si po funksionon ajo”, thotë ai.

Rizaj këshillon që njerëzit të mësojnë ta përdorin inteligjencën artificiale, por njëkohësisht të kenë më shumë kujdes me të dhënat personale, veçanërisht ato të fëmijëve. **/REL**

Etiketa: AI | inteligjenca artificiale

Lajme të lidhura



Korreshi ironizon Qeverinë:
Fshati akoma të parmenda, ju na tregoni inteligjencën artificiale

19:55 : 17/09/2026



Fituesja e Çmimit Nobel: Duhet ta kufizojmë inteligjencën artificiale, përndryshe njerëzit do humbasin kontrollin

09:12 : 16/09/2026



OKB ngre alarmin për inteligjencën artificiale: Rreziqe të paprecedentë

21:10 : 15/09/2026



Trump kundër ngadalësimit të ritmit të AI: Ide kineze, SHBA duhet të ruajë epërsinë

11:45 : 15/09/2026



Presidentja e Bankës Qendrore Evropiane: Evropa rrezikon të mbetet peng i SHBA-së dhe Kinës për AI

09:28 : 15/09/2026



“Po ekspozon jetën e njerëzve”/ OKB kërkon ndërhyrje urgjente për Inteligjencën Artificiale

18:01 : 14/09/2026



RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.